



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e -X-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
15 nëntor 2018 në sallën e komunës, e cila filloi në ora 14:15.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Fjolla Ujkani, Ymer Haradinaj, Rrezarta Krasniqi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Melihate Basholli-Latifi dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Besim Muzaqi (nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Miran Halili, Berat Sadiku), Ismet Gashi, nga zyra ligjore, si dhe nga sekretaria e kuvendit, Haki Maloku, Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ai kërkoi që të futet në rend të ditës <Shqyrtimi i Draft-statutit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës së Vushtrrisë>.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – kërkoi që për kuvend të sillen informata për gjendjen shëndetësore të qytetarëve në Komunën e Vushtrrisë, pasi që ka qenë e paraparë me Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për muajin nëntor. Sepse, drejtori nuk ka të drejtë ta heq nga rendi i ditës këtë informatë, pasi që është një plan i kuvendit që është votuar në mënyrë unanime.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – tha se kjo informatë ka qenë pjesë e planit të punës së kuvendit, kurse raportimin vjetor para anëtarëve të kuvendit dhe qytetarëve e bën kryetari i komunës. Prandaj, qëllimi i raporteve dhe informatave që vijnë në kuvend është që anëtarët e kuvendit të njoftohen për proceset që kanë ndodhur deri në atë kohë dhe të shikohet se a ka ngelur diku procesi. Prandaj, ne si anëtarë të kuvendit jemi të interesuar ta dimë se deri ku kanë shkuar projektet në lëmin e shëndetësisë.

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – theksoi se drejtorja jonë nuk e ka problem që ta sjell këtë informatë në këtë mbledhje, por nuk do të pasqyrohen informatat për tërë vitin dhe se nuk jepen në mënyrë të detajuar investimet kapitale që janë në proces e sipër. Sipas meje, më mirë është që edhe për shëndetësinë, por edhe për anëtarët e kuvendit ta kenë raportimin e plotë për vitin 2018 në mbledhjen e muajit shkurt të vitit 2019.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – deklaroi se informata do të përgatitet nga ana e drejtorisë për këtë mbledhje, ashtu siç ka qenë e planifikuar, kurse do të bëhet edhe një raportim shtesë në muajin shkurt të vitit 2019, në mënyrë që të krijohet një praktikë e tillë, në mënyrë që të përmbillet një vit kalendarik dhe fiskal.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 15.10.2018;
2. Shqyrtimi i Raportit i sistemit të menaxhimit të performancës së komunës, në ofrimin e shërbimeve për vitin 2017;
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal;
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e ambientit;
5. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore në Komunën e Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve, si dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;
7. a. Shqyrtimi i Draft-statutit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës së Vushtrrisë.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 15.10.2018

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – tha se në faqen 6 të procesverbalit nuk është përfshirë krejt atë që e kam thënë. Ajo tha se ka kërkuar informacione se deri ku ka shkuar propozimi i saj që një shkollë në Vushtri që është pa emër të emërtohet me emrin e “Hajzer Krasniqit”. Por, nuk është përfshirë kjo pjesë në procesverbal: “është kërkesa e dytë që nuk ka marrë përgjigje për këtë”.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se në faqen 4 tek <Shqyrtimi i Raportit janar-shtator 2018 për të hyrat dhe shpenzimet> nuk mund ta fajësojë procesmbajtësin për këtë, pasi që në mbledhjen e KPF-së na është sjellë një tabelë me të dhëna të gabuara dhe sipas asaj table unë edhe kam diskutuar. Ndërsa, në kuvend na është sjellë tabela e përmirësuar. Prandaj, ai pyeti edhe zyrën ligjore se qysh do të mbeten në procesverbal ato që i kam thënë, pasi që unë kam rënë në lajthitje në bazë të asaj table.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri me ndryshime aprovoi procesverbalin e datës 15.10.2018.

2. Shqyrtimi i Raportit i sistemit të menaxhimit të performancës së komunës, në ofrimin e shërbimeve për vitin 2017

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – tha se po e shoh që kemi dalë në renditje në vendin e 12-të, gjë që kjo nuk është një renditje e mirë për neve si komunë. Po shpresojmë se për vitin 2018 do të kemi një renditje më të mirë. Ajo tha se për mua ka qenë shqetësuese mospunësimi i personave me aftësi të kufizuara. Kësaj kategorie duhet t'i japim prioritet, sepse ata persona janë të barabartë me ne.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – edhe pse nuk erdha i përgatitur të diskutojë për këtë pikë të rendit të ditës, duke menduar se personi përgjegjës (Islam Latifi) për këtë çështje do të

jetë i pranishëm në mbledhje. Ky raport ka të bëjë me vitin 2017 dhe se edhe nëse jemi në vendin e 12-të nuk jemi në situatë të keqe. Nga ky raportim, kemi përfituar mbi 150 mijë euro grant nga DEMOS-i, për shkak të këtyre rezultateve, shprehet Muzaqi. Ai tha se nuk është kompetent për të diskutuar për këtë, por në mbledhjen e kuvendit do të jetë i pranishëm personi përgjegjës.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroi se pajtohet me atë që e tha Rrezarta lidhur me kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, sepse ka qenë ndër arritjet më të ulëta, pasi që nuk merren parasysh në punësim si kategori. Prandaj, ekzekutivi i komunës duhet që ta shikojë se në cilat fusha ka pasur ngecje dhe të punohet në to për ta përmirësuar performancën.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – deklaroi se jemi munduar që t'i adresojmë këto të gjetura në mënyrë që për të ardhmen t'i përmirësojmë.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – tha se edhe unë pajtohem me Rrezartën lidhur me atë që personat me aftësi të kufizuara të jenë prioritet në punësim dhe ky le të jetë një sugjerim për qeverinë komunale. Ajo theksoi se në vitin 2018 frikësohem se do të kemi performancë më të dobët, e që sipas meje është dashur të kemi performancë më të mirë. Përveç punësimit të personave me aftësi të kufizuara, ajo ceku edhe punësimin në baza gjinore, ku për shkak të kësaj kishte vërejtje rreth përbërjes së KPF-së. Po ashtu do të ndikojë edhe numri i vogël i drejtoreshave (qoftë ne ekzekutiv, qoftë në institucione tjera). Në fund tha se edhe furnizimi i qëndrueshëm me ujë të pijes, është një çështje që nuk është realizuar.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se edhe unë pajtohem që duhet t'iu jepet prioritet personave me aftësi të kufizuara. Ai pyeti se a është bërë vlerësimi i shërbyesve civilë? Pasi që ka disa punëtorë që i neglizhojnë disa punë, sepse kjo neglizhencë ndikon në qeverisje dhe në jetën e qytetarëve. Po ashtu, shqetësuese është gjendja e furnizimit me ujë të pijes. Ai kërkoi që të punohet në këtë drejtim dhe rritet efikasiteti dhe të ketë mbulueshmëri për të gjitha vendbanimet. Po ashtu, të punohet edhe në trajtimin e ujërave të zeza, në mënyrë që të bëhet parandalimi i përhapjes së epidemive të ndryshme që do të rrezikonin qytetarët.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – pyeti se cilat objekte hyjnë në kategorinë e parë dhe të dytë? Po ashtu, ajo kërkoi që për kuvend të plotësohet kjo informatë dhe të paraqiten rrënimet e objekteve për vitin 2018 dhe arsyet e tyre, si dhe kërkesat që i kanë bërë kafiteritë për t'u pajisur me leje dhe që nuk u janë aprovuar.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – sqaroi se në kategorinë e parë hyjnë objektet e vogla (shtëpitë), kurse në kategorinë e dytë hyjnë objektet e larta (banesat) me sipërfaqe mbi 450m². Sa i përket listës së pajisjes me leje, këto do të jenë publike në web-faqe në fund të vitit, kurse, sa i përket rrënimeve të objekteve, kjo nuk është në kompetencë të drejtorisë sonë, por në kuadër të Drejtorisë për Inspektime. Ai theksoi se të gjitha lejet që janë lëshuar deri më tani janë në harmoni me Planin zhvillimor komunal (PZHK), Ligjin e Ndërtimit, udhëzimet administrative dhe rregulloren komunale.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – pyeti se në çka bazohet drejtoria për t'i pajisur me leje ndërtimore objektet e larta mbi 450m²?

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – deklaroi se lejet ndërtimore i lëshojnë në bazë të Ligjit për Ndërtim, udhëzimit administrativ dhe rregullores komunale, kurse, PZHK-në e përdorim vetëm për pjesën që është i destinuar ndërtimi. Sipas tij, kanë ekzistuar tri plane rregulluese që janë shfuqizuar dhe që nuk është dashur të ndodhë kjo dhe se është një kthim prapa. Jemi në proces të hartimit të Hartës Zonale, ku jemi në hapat e parë dhe në bashkëpunim me organizatën UN HABITAT do ta hartojmë këtë dokument.

Ismet Gashi, nga Zyra ligjore – theksoi se planet rregulluese i ka shfuqizuar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e jo Kuvendi i Komunës.

Berat Asllani, drejtor i Drejtorisë për Inspektime – deklaroi se drejtoria gjatë kësaj periudhe ka pasur vetëm një rrënim, i cili ka qenë një subjekt afarist. Ai theksoi se nga data 31 maj 2018, nuk kemi kompani të rrënimit. Dy herë ka dështuar tenderi për një gjë të tillë, për shkak se nuk kishte kompani të interesuara që të konkurronin.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e ambientit.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – pyeti se a është menduar që të ndërtohet ndonjë stacion për matjen e cilësisë së ajrit. Ai tha se aktualisht matja e ndotjes së ajrit po bëhet nga ambasada amerikane, e cila pikën e matjes e ka në qendër të Prishtinës dhe se ky nuk është një matës real, sepse matet vetëm PM 2.5, i cili është një pluhur që nuk shihet me sy. Ndërkaq, në Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës gjendet stacioni për matjen e ndotjes së ajrit, por që fatkeqësia është se qytetarët i besojnë më shumë matjes nga ambasada amerikane, kurse, nëpër portale informative janë përhapur informacione se gjendja është alarmante. Mirëpo, në realitet sipas meje nuk është një gjendje e tillë, pasi që nuk kemi një matje reale. Sipas Klinakut, drejtoria do të ishte mirë që të mendonte që përmes ndonjë projekti ta sigurojë një matës mobil për matjen e cilësisë së ajrit, i cili do të vendosej në qendër të qytetit në Vushtrri.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – tha se është një këshillë e mirë nga Neziri për matjen e cilësisë së ajrit. Sa i përket informatës, ai tha se të gjitha projektet e qeverisjes së kaluar janë duke u realizuar, duke përfshirë rrugët, trotualet, vijat e kanalizimit, pastrimi i deponive ilegale, pastrimi i lumenjve etj, të cilat ndikojnë në mbrojtjen e mjedisit.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – i informoi të pranishmit se në fshatin Stanoc i Epërm para dy apo tri viteve është kryer projekti i kanalizimi. Ky ishte një projekt i përbashkët në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe të Obiliqit, i cili është punuar shumë keq, pasi që gypat që janë vendosur në lumë, kanë dalë nga vendi dhe se kanalizimet e disa lagjeve derdhen në lumë. Sipas tij, në atë lumë po kundërmon një erë e keqe dhe ekziston rreziku i përhapjes së ndonjë epidemie. Ai kërkoi që të krijohet një komision dhe ta verifikojë gjendjen dhe sipas mundësive të intervenohet për rregullimin e tij.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – u shpreh se lidhur me këtë çështje ka pasur takim me drejtorin e urbanizmit në Obiliq. Ky projekt është udhëhequr nga Komuna e Obiliqit dhe siç më njoftoi drejtori kanë pasur probleme me kompaninë që e ka realizuar atë projekt, ku lënda ka përfunduar edhe në gjykatë. Mirëpo, projekti ende nuk ka përfunduar dhe se kompania është duke punuar. Prandaj, kam kërkuar zyrtarisht nga drejtori i urbanizmit që të intervenohet edhe në territorin e komunës sonë, aty ku janë paraqitur problemet.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore në Komunën e Vushtrrisë

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – pyeti se a ka inspektime të rregullta në furrat e bukës dhe markete, apo ka edhe inspektime të papritura. Ajo tha se në një furrë të bukës kur shkoj me ble bukë, e vërej vet kohën kur do të shkojnë inspektorët për inspektime, sepse shërbimi bëhet me dorëza, por, ka raste që ai shërbim bëhet edhe pa dorëza. Po ashtu, ajo pyeti se a bëhen inspektime të punëtorëve për moshën e tyre. Kjo për shkak se unë e kam njohur një qytetare që ka pasur në moshë rreth 16 vjeç, e cila ka punuar në një dyqan.

Berat Asllani, drejtor i Drejtorisë për Inspektime – deklaroi se inspektimet janë të vazhdueshme dhe të rregullta nga ana e inspektorëve. Kemi pasur rast që e kemi mbyllur një furrë për shkak të kushteve higjienike. Lidhur me moshën e punëtorëve, ai sqaroi se bëhen edhe këto inspektime, por ka raste që mund të ketë ndonjë lëshim.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve, si dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë

Berat Asllani, drejtor i Drejtorisë për Inspektime – i informoi të pranishmit se në përgatitjen e kësaj informate është kontribuese edhe Drejtoria për Inspektime.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së – kërkoi tek numri i të punësuarve të ceket edhe periudha e të punësuarve.

Miran Halili, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – theksoi se është e vërtetë që kemi pasur bashkëpunim me Drejtorinë për Inspektime, ku për shkak të inspektimeve nga ana e inspektorëve, bizneset kanë ardhur ta bëjnë regjistrimin e tyre, edhe pse ky regjistrim është falas.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

7. a. Shqyrtimi i Draft-statutit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës së Vushtrrisë

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se duhet që edhe zyra ligjore t'i ndihmojë komisionit statutar, sepse janë tejkaluar disa çështje thelbësore, kurse fokusin kryesor ky komision e ka pasur tek drejtoritë. Ai tha se edhe më herët isha i interesuar që të ndryshohet statuti për shkak të disa defekteve që ekzistojnë në të dhe se ka kolizion me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (LVL). Ai tha se vet titulli i këtij drafti është gabim, sepse statuti do të mbetet dhe se vetëm disa nene do të ndryshohen; pastaj, tek pjesa hyrëse, nuk kemi nën 12.2, por është neni 12, paragrafi 2; tek neni 3 i draftit thuhet: <Komuna e Vushtrrisë është e përbërë prej këtyre fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane>. Klinaku tha se këtu duhet të ceket që <emërtimi i fshatrave dhe vendbanimeve duhet të jetë në harmoni me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave>. Ai shtoi se e kemi një gjendje interesante në komunën tonë, ku emërtimi i fshatrave dallon me zonat kadastrale, që nuk është dashur të dallojë. Pastaj, kemi më shumë vendbanime sesa zona kadastrale dhe po ashtu, në qytet nuk ekzistojnë lagjet.

Tek neni 4 i draftit të ceket kush i themelon zyrat, e jo të hiqet krejt paragrafi 2 qysh është thënë në draft; ai pyeti tek neni 8 i draftit se: <çka nënkuptohet me shumicën e thjeshtë>; tek neni 10 i draftit është një ngatërrim, sepse mbledhjet e jashtëzakonshme i parasheh ligji. Mua po më duket e paqartë dhe po i bie sikur po hiqen mbledhjet e jashtëzakonshme e po shtohet një nen i ri për mbledhjet urgjente. Tek neni 13 i draftit që flet për nenin 57 të statutit lidhur me komitetet konsultative, Klinaku propozoi që të themelohet Komiteti konsultativ për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së; tek neni 71, që flitet për themelim të drejtorive, ai propozoi që të mbesin vetëm dy alternativa: Ose kuvendi ose kryetari t'i themelojë drejtoritë, kurse, alternativa e tretë ku në draft thuhet që drejtoritë t'i themelojë kuvendi me një akt të veçantë me shumicën e anëtarëve apo me 2/3 për mua është një kamuflim; Klinaku propozoi që të hiqet krejt neni 26 i statutit që flet për referendumin, sepse është e palogjikshme përderisa nuk kemi ende ligj për referendumin; tek neni i 48 i statutit ku flitet për rendin e ditës, duhet të sqarohet kjo çështje, sepse po ka raste që edhe pas miratimit të rendit të ditës po propozohen pika për t'u futur në rend të ditës për shqyrtim, madje edhe krejt në përfundim të mbledhjes; ai propozoi që neni 52 i statutit që flet për <grupin kuvendar> të hiqet krejt, pasi që LVL-ja nuk flet për grupet kuvendare. Në fund tha se ndryshimi i statutit po mbetet peng i nenit 71 për themelim të drejtorive.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – deklaroi se pajtohet me propozimet që i paraqiti Neziri. Ajo pyeti se numri i drejtorive a është i përkufizuar, pra a është një numër konstant i tyre se sa do të jenë me këtë draft-statut? Apo nëse i lihen kompetencat kryetarit për themelim të drejtorive, a do ta ketë ai të drejtën të themelojë sa të dojë ai drejtori?.

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – u shpreh se ndryshimi i statutit është dashur të ndryshohet edhe më herët për shkak se është vjetërsuar dhe se janë bërë disa ndryshime në legjislacionin. Prandaj, ky statut duhet të harmonizohet me këtë legjislacion. Ai tha se ndryshimet në statut duhet të jenë përmbajtësore dhe të shikohet secili nen, e jo vëmendja të përqendrohet tek drejtoritë. Një defekt tjetër është se komuna jonë nuk i ka krijuar lagjet në qytet, gjë që po kemi vështirësi ne si drejtori për këtë. Ai kërkoi që të themelohet një komision nga kuvendi i komunës dhe ekzekutivi që të caktohen lagjet e qytetit. Po ashtu, kemi edhe emërtime të fshatrave gabimisht, ku në fshatin Lumadh kemi dy institucione shëndetësore, njëra në kompetencë të komunës e tjetra në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë, ku emërtimi i fshatit në tabelë është i ndryshëm, tek njëra shkruhet <Lumadh>, tek tjetra <Lumi i Madh>.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – theksoi se statuti edhe në mandatin e kaluar ka pasur tendencë që të ndryshohet për shkak që të bëhet harmonizimi me legjislacionin në fuqi. Sa i përket lagjeve, ndoshta jo doemos duhet të jenë në statut. Mirëpo, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit së bashku me një komision të kuvendit të komunës duhet të punojë për emërtimin e lagjeve në qytet. Sa i përket rendit të ditës se a duhet të hyjnë pikat në rend të ditës edhe pas miratimit të tij, Zhegrova tha se këtë e parasheh ligji dhe se për ndonjë rast emergjent e shoh të arsyeshme nëse hyn në rend të ditës edhe pas miratimit të tij, p.sh. për ndonjë ndihmë për shërim që është rast emergjent. Lidhur me nenin 71 për themelim të drejtorive, Zhegrova tha se duhet të jenë vetëm dy alternativa: kuvendi ose kryetari. Kjo alternativa tjetër e propozuar është që t'i vë në lajthitje anëtarët e kuvendit, sepse sipas ligjit janë vetëm dy raste kur votohet me 2/3: për statutin dhe simbolet, në rastet tjera votohet me shumicë të thjeshtë, vetëm në rastet kur me ligj specifik parashihet ndryshe. Sipas tij, themelimi i drejtorive duhet të jetë në kompetencë të kuvendit, por detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorive mund të bëhen edhe me vendime të veçanta dhe të ceken në statut, por jo të lihet në kompetencë të kryetarit shuarja e drejtorive. Edhe gjatë mandateve të kaluara ka pasur tendenca për rritje të numrit të drejtorive, por unë kam qenë kundër, tha ai, i cili shtoi se prapë është ihtar i asaj që numri i drejtorive të zvogëlohet.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se i beson këtij komisioni që e ka bërë këtë draft të statutit. Ai tha se drafti do të shkojë në kuvend dhe diskutim publik dhe është rasti që edhe aty të jepen vërejtje, e mos të humbim kohë me gjëra të njëjta, por ta procedojmë këtë draft në kuvend.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – pyeti se nëse shtohet një drejtori e re, cili do të jetë fati i shërbyesve civilë që nuk janë të profilin adekuat me drejtorinë e krijuar apo të dërgohet në ndonjë drejtori që nuk e ka profilin adekuat.

Haki Maloku, përgjegjës i sekretarisë – tha se me LVL nuk është i përcaktuar numri i drejtorive, sepse aktualisht është kompetencë e kuvendit të komunës të vendosë për numrin e tyre. Lidhur me vendbanimet, ai tha se pajtohet që të zbatohet ligji. Mirëpo, në statutin aktual janë tri fshatra që në Ligjin për Kufijtë Administrativ mungojnë: Dumnica e Epërme, Mavriqi dhe Sfaraçaku, kurse në zonat kadastrale figurojnë këto vendbanime. Maloku tha se të gjitha vërejtjet me shkrim ua kemi dërguar nivelit qendror sa i përket saktësisë së emërimit të vendbanimeve, por nuk i kanë marrë parasysh dhe nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se ekzistojnë 65 zona kadastrale që i kanë kufijtë e vet dhe që njihen në kadastrat e Kosovës. Por, fshati Mavriq nuk ka kufi të përcaktuar dhe nuk dihet ku fillon e ku përfundon. Pastaj tha se duhet të kërkohet nga niveli qendror që të bëhen këto përmirësime dhe pastaj në Ligjin për Kufijtë Administrativ të përmirësohen, e më pas statuti të harmonizohet me këtë ligj sa u përket vendbanimeve.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se si komision kemi mbajtur 6 apo 7 takime dhe duke u bazuar në legjislacionin që është në fuqi kemi përgatitur këtë draft-statut. Gjatë punimeve në komision kemi diskutuar që të krijohet një komision i kuvendit për përcaktimin e zonave të qytetit. Haradinaj theksoi se Drejtoria e Prokurimit ishte në kundërshtim me ligjin, prandaj ajo mund të shuhet dhe krijon hapësirë për një drejtori tjetër. Komisioni e ka kryer punën e tij, nuk po them që e kemi bërë punën më të mirë, por brenda mundësive kemi dhënë kontributin tonë, kurse, punën e madhe në komision e kanë bërë juristët: Idriz Muzaqi dhe Haki Maloku, ndërkaq ne u kemi ndihmuar me vërejtje dhe sugjerime. Statuti nuk do t'i përshtatet një kryetari të komunës, por do t'i shërbejë interesave të qytetarëve.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

Të ndryshme.

Për shkak se Islam Latifi nuk ishte i pranishëm kur u shqyrtua pika e dytë < Shqyrtimi i raportit i sistemit të menaxhimit të performancës së komunës, në ofrimin e shërbimeve për vitin 2017> ai i informoi të pranishmit lidhur me këtë çështje.

Islam Latifi, koordinator komunal për raportim të performancës – tha se në raport, i cili është bërë për vitin 2017 janë përfshirë të gjeturat dhe arritjet e komunës, ku ne si komunë jemi renditur në vendin e 12. Ai tha se janë dhënë rekomandime për të përmirësuar shërbimet në të ardhmen në ato çështje ku qëndrojmë më ulët. Pastaj tha qëndrojmë ulët sa i përket vlerësimit të punëtorëve. Komuna e ka bërë vlerësimin e punëtorëve, mirëpo nuk e ka bërë në harmoni me udhëzimin administrativ. Po ashtu, kemi vlerësim të ulët edhe tek ligjshmëria e kontratave për shërbime të veçanta. Latifi tha se për dy vite, komuna jonë ka përfituar grant për performancë të mirë.

Mbledhja përfundoi në orën **16:25**.

Bujar Klinaku

Ble Rregaj
Procesmbajtës



Nasuf Aliu

Nasuf Aliu
Kryesues i KK-së dhe i KPF- së